Neni 32 Testet për përfundimin

32.1 Punët nuk do të pranohen deri sa të jene kryer verifikimet dhe testet e caktuara në shpenzime të Kontraktuesit. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktues për datën në të cilën verifikimi dhe testet të tilla mund të fillojnë.

32.2 Punët të cilat nuk plotësojnë kushtet e kontratës, duhet, nëse kërkohet, të shkatërrohen dhe rindërtohen nga kontraktuesi ose të riparohen, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues, përndryshe kjo do të bëhet pas njoftimit të duhur në shpenzime të Kontraktuesit, me urdhër të Autoritetit Kontraktues.

Neni 33 Pranimi i përkohshëm

33.1 Punimet do të merren përsipër nga Autoriteti kontraktues kur të kenë kaluar në mënyrë të kënaqshme testet për pranim dhe të jete lëshuar, ose konsiderohet të jete lëshuar, një certifikatë e pranimit të përkohshëm.

33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jenë të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërrimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një **certifikatë të pranimit përfundimtar**, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të parealizuar në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

- 36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.
- 36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:
- a) dëmet; dhe/ose
 - b) ndërprerjen e kontratës.
- 36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:
- a) dëme të përgjithshme; ose
 - b) dëme të likuidueshme.
- 36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

- 37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.
- 37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:
- a. Kontraktuesi ndërprente punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
 - b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonës;
 - c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
 - d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
 - e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
 - f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.
- 37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.
- 37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.
- 37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

- 38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.
- 38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:
- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
 - ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.

iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.

iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.

v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riatdhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimin.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 24,111.11€
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve [shëno shumat]; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve [shëno shumat]; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën [shëno shumat]; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: [shëno shumat] (ii) të personave të tjerë: [shëno shumat]
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda 3 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 3 ditë
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 08.09.2025
	17.2	Përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë brenda 70 ditëve
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% e Çmimit r të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës .
Regjistri i punës	20.1	[Specifikoni nëse një regjistër i punës nuk është nevojitet].
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është Rufat Muqa, ndërsa Mbykqyrës të drejtëpërdrejt janë Skender Sopa dhe Mentor Shehu
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: [shëno shumën]
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: [shëno përqindjen]

Shkaqet kompensim për	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Perioda garantuere e defekteve është 365+30 ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është [shëno përqindjen].
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	[Specifikoni departamentin e Komisionit përgjegjës për pajtim]
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	[shëno te dyja] a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [specifikoni gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të [specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes] në pajtim me [specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].

PARAMASA DHE PARALLOGARIA					
Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike në lokacionet: Kaçanik, Begracë dhe Kovaçec					
A. Parku i banesave përballë stacionit të autobusëve					
Nr. R.	Pozicionimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera (€)
1	PUNËT PËRGADITORE				
1.1	Pregaditja e punishtës duke përfshirë rrethimin dhe të gjitha aktivitetet që mundësojnë fillimin dhe mbarvajtjen e sigurt të punimeve.	paushall	1.00	1.00 €	1.00 €
1.2	Piketimi gjedezik për fushë dhe elementet tjera përcjellëse.	paushall	1.00	1.00 €	1.00 €
Gjithësej 1					2.00 €
2	PUNËT E DHEUT				
2.1	Gërmimi dhe transporti deri në deponi me gjatësi max 15km l dheut të kategoris III dhe IV me trashësi rreth d=45cm duke e përfshirë kubëzat ekzistuese, anësoret, muret rrethuse dhe të gjitha elementet përcjellëse sipas projektit.	m ³	1,166.37	2.50 €	2,915.92 €
2.2	Gërmimi dhe transporti deri në deponi me gjatësi max 15km l dheut të kategoris III dhe IV me thellsi maksimale 1.6m gjersi të kanalit t=80cm për vendosjen e gypave të kanalizimit.	m ³	332.80	2.50 €	832.00 €
2.3	Planifikimi, ngjeshja dhe kompaktimi l nën bazës pas përfundimit të grryerjes me mv>30Mn/m ²	m ²	2,591.93	0.50 €	1,295.97 €
2.4	Furnizimi, transporti dhe punimi l shtresës nga Gjeotekstili 350gr/m ²	m ²	1,497.93	1.30 €	1,947.31 €
2.5	Furnizimi, transporti dhe punimi l rësës për mbulimin e gypave të kanalizimit atmosferik.	m ³	83.20	5.00 €	416.00 €
2.6	Furnizimi, transporti dhe punimi l tamponit 0-63.5mm për mbulimin e kanalit të kanalizimit atmosferik.	m ³	249.60	7.00 €	1,747.20 €
2.7	Furnizimi, transporti dhe punimi l shtresës nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-63 mm), i ngjeshur me trashësi 30cm me Mv>60Mn/m ² , në hapsirat u fushave, shtegut për ecje dhe hapsirave tjera sipas vizatimit.	m ³	504.88	8.00 €	4,039.03 €
2.8	Furnizimi, transporti dhe punimi l shtresës nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-31.5mm), i ngjeshur me trashësi 15cm me Mv>80Mn/m ² , në hapsirat u fushave, shtegut për ecje dhe hapsirave tjera sipas vizatimit.	m ³	252.44	10.00 €	2,524.40 €
Gjithësej 2					15,717.82 €
3	PUNËT E KUBËZAVE, ANËSORET				
3.1	Sigurimi dhe montimi l gurëve skajor nga betoni l parapregaditur 8/20cm me klas C35/45 - M100.Në llogari hyn edhe punimi l bazës prej betoni.	m'	539.00	7.00 €	3,773.00 €
3.2	Sigurimi dhe montimi l gurëve skajor nga betoni l parapregaditur 20/24cm me klas C35/45 - M100.Në llogari hyn edhe punimi l bazës prej betoni.	m'	59.00	14.00 €	826.00 €
3.3	Furnizimi, transporti dhe montimi l kubëzave të betonit me ngjyrë colormix me trashësi t=8 cm (dy-shtresore). Kubëzat duhet të jenë me aditiv kundër ujëpërshkueshmërisë të aplikuar në të dy shtresat. Kubëzat duhet të jenë me rezistencë në çarje prej 3.6 Mpa, konform standardit EN 1338. Në këtë pozicion hyn edhe punimi l shtresës së rërës nën kubëza me trashësi 4 cm (furnizimi dhe transporti), ngjeshja e tyre pas montimit me mekanizëm përkatës, mbulimi l fugave me rërë dhe pastrimi përfundimtarë i tyre. Lloji dhe dizajni l kubëzave të caktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	1,497.53	14.00 €	20,965.42 €
3.4	Furnizimi, transporti dhe montimi l kubëzave të betonit me ngjyrë të zezë me trashësi t=8 cm (dy-shtresore). Kubëzat duhet të jenë me aditiv kundër ujëpërshkueshmërisë të aplikuar në të dy shtresat. Kubëzat duhet të jenë me rezistencë në çarje prej 3.6 Mpa, konform standardit EN 1338. Në këtë pozicion hyn edhe punimi l shtresës së rërës nën kubëza me trashësi 4 cm (furnizimi dhe transporti), ngjeshja e tyre pas montimit me mekanizëm përkatës, mbulimi l fugave me rërë dhe pastrimi përfundimtarë i tyre. Lloji dhe dizajni l kubëzave të caktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	180.50	14.00 €	2,527.00 €
Gjithësej 3					28,091.42 €

4	DRENAZHIMI				
4.1	Furnizimi, transporti, pregatitja dhe vendosja e rigolave nga betoni me klasë C30/37 i papërshkueshem nga uji dhe i çendrushem ndaj ngricave me gjersi b=35cm (Betoni të jetë i natyralizuar).	m'	40.00	10.00 €	400.00 €
4.2	Furnizimi dhe ndërtimi i pusetave kontrollues nga betoni i armuar me shpuarjen e hapsirave për vendosjen e gypave të kanalizimit, lidhja e gypave me llaq çimentoje. Për secilin pusetë është e nevojshme të furnizohen unazat e prerjes konstante Ø1000 mm dhe nga një unazë në formë të konit (Ø1000mm në Ø700 mm) në pjesën e ngushtë të cilit montohet korniza me kapakun e rëndë, shkurtohet sipas nevojës në varshmëri të ndryshimit të lartësisë së pusetës. Është e nevojshme të furnizohen unaza në formë të konit dhe me formë konstante, me thellsi mesatare h=2.1m	copë	10.00	150.00 €	1,500.00 €
4.3	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i kapakëve prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	10.00	80.00 €	800.00 €
4.4	Furnizimi transporti montimi dhe betonimi i ujëmbledhsave prej gize, për pesha të rënda. Në çmim të llogaritet edhe betonimi i kurorës prej betonarmesë C-25/30.	copë	11.00	70.00 €	770.00 €
4.5	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë. Pagesa bëhet për 1m' të gypit të montuar komplet, për kolektorë DN- 200 mm	m'	25.00	5.00 €	125.00 €
4.6	Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorë. Pagesa bëhet për 1 m' të gypit të montuar komplet, për kolektorë DN- 250 mm	m'	240.00	7.00 €	1,680.00 €
4.7	Realizimi i pikës shkarkuese të rrjetit të kanalizimit atmosferik në shtratin e lumit Lepenc duke përfshirë edhe kthimin në gjendjen para intervenimit.	copë	2.00	1.00 €	2.00 €
Gjithësej 4					5,277.00 €

5	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Totali
NDRIÇIMI					
5.1	Gërmimi i kanalit të gjatë 50 m prej Furnizimit deri te KSHN, kanalit 240 m prej KSHN përgjatë shtegut parkut dhe fushave sportive sipas vizatimeve, me dimensione (80x60)cm, ashtu siç është paraqitur në situacion, për shtrirjen e gypave PE të brinjëzuar Ø 50m. Në çmim të kalkulohet edhe largimi i dheut nga punishtja me largësi min 15km. Në këtë pozicion hynë edhe planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m³	139.2	2.50 €	348.00 €
5.2	Porosia, transporti dhe vendosja e gypave RESN4 Ø 50 të brinjëzuar për pershkim të kabllit prej Trafos deri te kuadrit shpërndarës i ndriçimit KSHN dhe pershkim të kabllit prej kuadrit shpërndarës të ndriçimit publik KSHN përgjatë Daljes 1 (N1-1-N13-1) dhe Daljes 2 (N1-2-N-10-2) (gjatësia e kanalit: 50m+240).	m	290	2.00 €	580.00 €
5.3	Furnizimi dhe vendosja e kabllos kryesore furnizuese NAYY- 4x25mm² prej TS deri te kuadri kryesorë shpërndarës i ndriçimit KSHN.	m	50	5.00 €	250.00 €
5.4	Furnizimi dhe vendosja e kabllos furnizuese NAYY- 4x16mm² prej kuadrit shpërndarës të ndriçimit KSHN për furnizimin e trupave ndriçues.	m	240	4.00 €	960.00 €
5.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit të zinguar Fe/Zn25x4mm në kanalizimin kablovik për tokezinimin e shtyllave të ndriçimit.	m	240	2.00 €	480.00 €
5.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit (0-4)mm në fundin e kanalit (50m+240)m prej furnizimit deri te KSHN dhe prej KSHN-së deri te trupat ndriçues, kanali është me dimensione (80x60) (10 cm rërë shtrohen në fund të kanalit dhe 20 cm mbi gypin e brinjëzuar Ø70mm).	m³	97.2	4.00 €	388.80 €
5.7	Mbulimi i kanalit (50m+240m) me dimensione (80x60cm). Mbulimi i tere me zhavor (0-60)mm). Ngjeshja në shtresë çdo 30cm deri në kuotën e terrenit.	m³	69.6	5.00 €	348.00 €
5.8	Furnizimi transporti dhe vendosja e mbrojtës të tiptit GAL.	m	240	1.00 €	240.00 €
5.9	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues "Rezik tensioni"	m	290	0.10 €	29.00 €

5.10	Blerja, transporti, montimi dhe lidhja e Kuadrit Shpërndarës të ndriçimit elektrik (KSHN) të ngjashëm me tipin KRO-RJ(A) prodh.TEP me mbrojtje IP65 i ndërtuar nga Poliesteri me dim : 1200x800x300 mm, me mbyllje hermetike te kapakut dhe me qelës. Kuadri vendoset në bazamentin prej betoni MB20 të përgatitur konform normave teknike. Pajisja që montohet në kuadër duhet të jetë nga materiali që nuk ndryshket kurse të gjitha lidhjet të mbrohen nga korrozioni. Kuadri duhet të përmbajë sipas skicës njëpolare të paraqitur në projekt këto elemente: 1. Njehsorin elektrik trefazor digjital të tipit MT174-D2A44-MK0Z i paisur me nderrues tarlfor 3x230/400V: 50Hz i miratuar nga MTI 2. Ndërprerës automatik, 3P, magneto-termik, Tip DPX 100-63A 4. Siguresat automatike katërpolare 50A ; - " 40A ; - " 32A ; - " 16A ; - " 6A 5. Kontaktorët për kyçje automatike të ndriçimit C-44 ,40A,380V 6. Releun digjital astrologjik për aktivizimin automatik te ndriçimit 7. Voltmetrin për kontrollimin e vlerës së tensionit në faza 8. Paket ndërpresin për kapërcim të tregimit të voltmetrit në faza 9. Prizën njëpolare për shërbime e servisme brenda kuadrit 10. Llambën ndiquese në brendi të kuadrit 11.Zbarrat prej bakri për lidhjen dhe përforcimin e përcuesve në faza, zbarrën e përcuesve të zeros dhe zbarrën e përtokzimit, 12. Shkarkuesit katodik dhe zbarrën për barazimin e potencialit.; Të gjithë elementet elektrik duke përfshirë dhe ormanët distributiv duhet të jenë të ndërtuar sipas normave teknike CE dhe IEC. Komplet	copë	1	500.00 €	500.00 €
5.11	Ndërtimi i bazamentit të betonit MB30, për KKSH të ndriçimit me dimensione 80x90x30cm	m³	0.3	200.00 €	60.00 €
5.15	Betonimi i bazamentit të 11 shtyllave me lartësi 4 m (shtyllat për ndriçimin e parkut dhe hapsirave rreth fushave sportive) (50x50x80)cm me beton të tipit C30/37	m³	2	300.00 €	600.00 €
5.16	Furnizimi dhe vendosja e shtyllave për ndriçimin e hapsirave te parkut dhe hapsirave rreth fushave sportive me gjatësi 4 metra në total (mbi tokë), nga çeliku S235JR me hot dip galvanizim dhe me trashësi të mureve 4mm. Shtylla do të fiksohet me mbjellje 0.8m Diametri i shtylles Ø140- Ø 60 , me trashësi të metalit 3.5 mm(Ø140) – 2.0 mm (Ø 76),Garancion ne shtylla - 25 vite	copë	11	210.00 €	2,310.00 €
5.17	Furnizimi dhe instalimi i llampave LED 22W (Lantern clasic Led ose ekuivalente) per ndriçimin e hapsirave te parkut të ndërtuar nga aliazhe alumini me mbyllje sikkone e rezistueshme ndaj nxehtësis dhe e mbuluar me PMMA. Tensioni: 110 - 270V (50 - 60Hz) Color temperature: Cree, XTE, 4500K Efikasiteti i ndriçueshmërisë: deri 130lm/W Jetëgjatësia: 100000 orë Mbrojta nga lagështia: IP65 Mbrojta mekanike: IK10 Klasa e siguriës: I Temperatura: -30 deri +60 grad celsius Shpërndarja e dritës: Asimetrike të paktën 4000lm. Kategoria S5 në pajtim me EN13201 Poashtu drita duhet të plotësoj EN60598 - 1:2008 dhe EN60598 - 2 - 3:2003	copë	11	50.00 €	550.00 €
5.18	Matja e tokzimit mbrojtës dhe dhënia e atestit të tokzimit	komplet	11	1.00 €	11.00 €
5.19	Montimi i kablllove në trafostacionin ekzistuese	komplet	1	1.00 €	1.00 €
5.20	Shqyrtimet e nevojshme te kablllove dhe tokezimit nga një kompani e licencuar për kete.	komplet	1	1.00 €	1.00 €
5.21	Punë të pa papapara në paramasë	komplet	1	1.00 €	1.00 €
Gjithësej 5					7,657.80 €

6	PUNËT E PARKUT DHE KËNDIT TË LOJËRAVE				
6.1	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses nga dheu organik i ngjeshur me trashësi t=15cm duke përfshir edhe Barin Natyror.	m ²	136.35	8.00 €	1,090.80
6.2	Furnizimi, transporti dhe mbjellja e drujëve dekorativ me lartësi hmin=2.5m dhe trashësi të trungur Ø80mm (Lloji do të përzgjedhet në konsulta me investitorin).	copë	28.00	80.00 €	2,240.00
6.3	Sigurimi i materialit, transporti dhe montimi i ulëseve. Ulëset duhet të jenë të dizajnuara njejtë sikurse ulësja e cila është e bashkangjitur me fotografi në këtë projekt duke përfshirë nga 2 blloqe betoni te parafabrikuar "Vinkell" me dimensione 100*55*50 në të cilën montohet pjesa e nga druri. Në llogari hyn punimi i bazës prej betoni për shtangimin e tyre dhe montimi i tyre. Llogaria të bëhet për copë të ulëseve.	copë	4.00	160.00 €	640.00
6.4	Furnizimi i materialit, transporti dhe montimi i shportave. Shportat duhet të jenë të dizajnuara njejtë sikurse shportat e cila është e bashkangjitur me fotografi në këtë projekt. Në llogari hyn punimi i bazës prej betoni për shtangimin e tyre dhe montimi i tyre. Llogaria të bëhet për copë të shportave.	copë	19.00	100.00 €	1,900.00
Gjithësej 9					5,870.80 €

A. REKAPITULIMI		
1	PUNËT PËRGADITORE	2.00 €
2	PUNËT E DHEUT	15,717.82 €
3	PUNËT E KUBËZAVE, ANËSORET	28,091.42 €
4	DRENAZHIMI	5,277.00 €
5	NDRIÇIMI	7,657.80 €
6	PUNËT E PARKUT DHE KËNDIT TË LOJËRAVE	5,870.80 €
TOTALI:		62,616.84 €

B.Parku rekreativ në fshatin Begracë					
Nr. R.	Pozicionimi	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Vlera (€)
1	PUNËT PËRGADITORE				
1.1	Pregaditja e punishtes duke përfshirë rrethimin dhe të gjitha aktivitetet që mundësojnë fillimin dhe mbarvajtjen e sigurt të punimeve.	paushall	1.00	1.00 €	1.00 €
1.2	Piketimi gjedezik për fushë dhe elementet tjera përcjellëse.	paushall	1.00	1.00 €	1.00 €
Gjithësej 1					2.00 €

2	PUNËT E DHEUT				
2.1	Gërmimi dhe transporti deri në deponi me gjatësi max 15km i dheut të kategoris III dhe IV me trashësi rreth d=45cm duke e përfshirë, muret rrethuse dhe të gjitha elementet përcjellëse sipas projektit.	m ³	181.35	3.00 €	544.05 €
2.2	Gërmimi dhe transporti deri në deponi me gjatësi max 15km i dheut të kategoris III dhe IV me trashësi rreth d=15cm në të cilën do të punohet hapësira gjelbëruese sipas projektit.	m ²	5,180.00	0.70 €	3,626.00 €
2.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-63 mm), i ngjeshur me trashësi 30cm me Mv>60Mn/m ² nën themele të mureve rrethuse dhe mureve të tribunave të fushes sipas vizatimit.	m ³	20.16	10.00 €	201.60 €
2.4	Planifikimi, ngjeshja dhe kompaktimi i nenbazës pas perfundimit të grryerjes me mv>30Mn/m ²	m ²	403.00	1.00 €	403.00 €
2.5	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses nga Gjeotekstili 350gr/m ²	m ²	403.00	1.50 €	604.50 €
2.6	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-63 mm), i ngjeshur me trashësi 30cm me Mv>60Mn/m ² , në hapsirat u fushave, shtegut për ecje dhe hapsirave tjera sipas vizatimit.	m ³	120.90	10.00 €	1,209.00 €
2.7	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses nga agregati i thyer guri gëlqerorë (0-31.5mm), i ngjeshur me trashësi 15cm me Mv>80Mn/m ² , në hapsirat u fushave, shtegut për ecje dhe hapsirave tjera sipas vizatimit.	m ³	60.45	10.00 €	604.50 €
2.8	Furnizimi, transporti dhe punimi i shtreses nga agregati i thyer guri 0-4 mm adkuat për pjesën e këndit të lojërave.	m ³	50.20	12.00 €	602.40 €
Gjithësej 2					7,795.05 €

3	PUNËT E ASFALTIT, KUBËZAT, ANËSORET, SHITESAT DHE SHENJËZIMET				
3.1	Sigurimi dhe montimi i gurëve skajor nga betoni i parapregaditur 8/20cm me klas C35/45 - M100.Në llogari hyn edhe punimi i bazës prej betoni.	m ²	62.00	8.00 €	496.00 €

3.2	Furnizimi, transporti dhe montimi i kubëzave të betonit me ngjyrë colormix me trashësi t=8 cm (dy-shtresore). Kubëzat duhet të jenë me aditiv kundër ujëpërshkueshmërisë të aplikuar në të dy shtresat. Kubëzat duhet të jenë me rezistencë në çarje prej 3.6 Mpa, konform standardit EN 1338. Në këtë pozicion hyn edhe punimi i shtresës së rërës nën kubëza me trashësi 4 cm (furnizimi dhe transporti), ngjeshja e tyre pas montimit me mekanizëm përkatës, mbulimi i fugave me rërë dhe pastrimi përfundimtarë i tyre. Lloji dhe dizajni i kubëzave të caktohet nga organi mbikqyrës.	m ²	142.00	14.00 €	1,988.00 €
Gjithësej 3					2,484.00 €

4	BETONI DHE ARMATURA				
4.1	Furnizimi, transporti, pregaditja dhe vendosja e betonit për themele dhe muret vertikale rrethuese të parkut, klasa e betonit C30/37 i papërshkueshëm nga uji (Betonit të jetë i natyralizuar dhe i paster pas largimit të pahive e nuk duhet të permirsohet me llaçë shtesë).	m ³	33.60	80.00 €	2,688.00 €
4.2	Furnizimi dhe vendosja e armaturës në strukturat e betonit, lloji S500. Krahës sasisë në specifikim është llogaritur edhe 3% për humbje nga prerja.	kg	1,680.00	0.80 €	1,344.00 €
4.3	Furnizimi dhe vendosja e mbrojtësve nga çeliku me lartësi h=90cm, dy profile horizontale me Ø75mm, mbështetje në beton duke përfshirë pllaken lidhëse dhe ankerimin në beton me të gjitha pozicionet në çdo 200cm, mbushjen vertikale me profile f20mm në distancë 110mm, lloji S500. çeliku i galvanizuar dhe plastifikuar.	m'	84.00	45.00 €	3,780.00 €
Gjithësej 4					7,812.00 €

5	NDRIÇIMI				
5.1	Gërmimi i kanalit të gjatë 300m prej Furnizimit deri te KSHN, kanalit 250 m prej KSHN përgjatë shtegut parkut dhe fushave sportive sipas vizatimeve, me dimensione (80x60)cm, ashtu siç është paraqitur në situacion, për shtrirjen e gypave PE të brinjëzuar Ø 50m. Në çmim të kalkulohet edhe largimi i dheut nga punishtja me largësi min 15km. Në këtë pozicion hynë edhe planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm.	m ³	144	2.50 €	360.00 €
5.2	Porosia, transporti dhe vendosja e gypave RESN4 Ø 50 të brinjëzuar për pershkim të kabllit prej Trafos deri te kuadri shpërndarës i ndriçimit KSHN dhe pershkim të kabllit prej kuadrit shpërndarës të ndriçimit publik KSHN përgjatë Daljes 1 (N1-1-N13-1) dhe Daljes 2 (N1-2-N-10-2) (gjatësia e kanalit: 50m+190m+175m).	m	50	2.00 €	100.00 €
5.3	Furnizimi dhe vendosja e kablos kryesore furnizuese NAYY- 4x25mm ² prej TS deri te kuadri kryesorë shpërndarës i ndriçimit KSHN.	m	50	5.00 €	250.00 €
5.4	Furnizimi dhe vendosja e kablos furnizuese NAYY- 4x16mm ² prej kuadrit shpërndarës të ndriçimit KSHN për furnizimin e trupave ndriçues.	m	251	5.00 €	1,255.00 €
5.5	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shiritit të zinguar Fe/Zn25x4mm në kanalizimin kabllorik për tokezim të shtyllave të ndriçimit.	m	42	2.00 €	84.00 €
5.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e zhavorit (0-4)mm në fundin e kanalit (70m+250)m prej furnizimit deri te KSHN dhe prej KSHN-së deri te trupat ndriçues, kanali është me dimensione (80x60) (10 cm rërë shtrohen në fund të kanalit dhe 20 cm mbl gypin e brinjëzuar Ø70mm).	m ³	72	5.00 €	360.00 €
5.7	Mbulimi i kanalit (70m+250m) me dimensione (80x60cm). Mbulimi i tere me zhavor (0-60)mm. Ngjeshja në shtresë çdo 30cm deri në kuotën e terrenit.	m ³	75	5.00 €	375.00 €
5.8	Furnizimi transporti dhe vendosja e mbrojtës të tipit GAL.	m	15	1.00 €	15.00 €
5.9	Furnizimi transporti vendosja e shiritit identifikues "Rezik tensioni"	m	300	0.10 €	30.00 €

